

INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve Prill 2025						
Nr. Rend or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	25.03.2025	Kërkojmë informacion lidhur me numrin e masave administrative të marra nga institucioni juaj nga vitit 2020, Me çfarë arsytimi janë marrë këto masa (shkeljet e subjekteve)?	02.04.2025	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (në vijim ISHTI) është institucioni qendror publik, i cili funksionon në mbështetje të Ligjit 10433, datë 16.06.2011" Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 410. 13.05.2015 "PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL ", dhe është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e: a) përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës; b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës; c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve në presion; ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror; d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës; dh) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor. Përgjatë periudhës kohore nga viti 2020 deri ne shkurt të vitit 2025, nga ana e ISHTIT janë ndëshkuar 284 (dyqind e tetëdhjetë e katër) subjekte tregtare. Për sa i përket natyrës së shkeljes administrative të konsumuar ka rezultuar se masat administrative në subjektet që ushtrojnë veprimtari të tregtimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të tyre vendosen në zbatim të ligjit nr.8450, 24.02.1999, ,” Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Për shkelje të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianeteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridik. Për shkelje të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse që u janë dhënë personave juridik, përfshirë dhe kushtet teknike dhe mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit. Për shkeljen e standarteve të miratuar për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj.	e plotë	0
2	27.03.2025	Kërkohet marrja e masave per ndalimin e menjehershëm te perdorimit te bombolave te oksigjenit	07.04.2025	Nga verifikimet e kryera, subjekti per te cilin eshte sjelle ankesa, disponon gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor per perdorimin e bombolave te oksigjenit	e plotë	0
3	04.04.2025	Kërkojme informacion mbi cilesine e naftes,duke qene se ne kemi nje flote te konsidrueshme te mjeteve qe perdorin te tille karburant , do te donim te ishim te interesuar mbi cilesine e naftes dhe benzines.	07.04.2025	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, nëpërmjet kryerjes të analizave në laborator të akredituar, për sasitë e naftës dhe nënprodukteve të saj të prodhuara në vend, të importuara, para zhdoganimit dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999,” Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, si dhe për të tretë. Bazuar në Raport Testimet e mostrave Gazoil dhe Benzinë, të marrë në stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve të analizuar në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve rezulton se nga data 01.01.2024 deri më datë 07.04.2025 nuk ka shkelje të treguesve të cilësisë dhe mostrat e analizuar kanë rezultuar sipas Standardit S SH EN 590:2022 për Gazoil dhe S SH EN 228:2012 + A1:2017 për Benzinë.	e plotë	0

4	08.04.2025	Kërkesë për informacion për marrjen e mostrave parazhdoganim	08.04.2025	Ne pergjigje te kërkeses tuaj te derguar me email me date 08.04.2025 ku kerkon informacion nese nga ana e ISHTI kryhet analizim i mostrave për artikullin White Spirit përpara zhdoganimit për një sasi prej 30411 litra White spirit, ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilesinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, nëpërmjet kryerjes të analizave në laborator të akredituar, për sasi të naftës dhe nënprodukteve të saj të prodhuara në vënd, të importuara, para zhdoganimit dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999," Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, si dhe për të tretë. Bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 14 të ligjit 8450, datë 24.02.1999," Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" bëjmë me dije se tregtimi me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre të vendit a të importit ushtrohet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqerive aksionare, pasi të jenë pajisur me licencë tregtimi, sipas dispozitave të këtij ligji. ISHTI fillon procedurën e marrjes së mostrave parazhdoganimit me dërgimin e Kopjes së Licencës së Tregtimit kategoria II/C shoqëruar me kërkesën për marrje mostre nga ana e subjektit tuaj.	e plotë	0
5	09.04.2025	Kërkesë-ankesë për verifikim të sigurisë së bombolave GLN, nëse I plotësojnë kushtet teknike.	14.04.2025	Subjekti për të cilin është kërkuar verifikimi i sigurisë së bombolave GLN që disponon, rezultojnë te këto mbyllur aktivitetin dhe po mbahet në vëzhgim	e plotë	0
6	11.04.2025	Kërkesë për verifikim të sigurisë së bombolave GLN	14.04.2025	Subjekti për të cilin është kërkuar verifikimi i sigurisë së bombolave GLN që disponon, rezultojnë te jete në rikonstruksion dhe nuk ka bombolave GLN	e plotë	0
7	14.04.2025	Kërkesë për vërtetim realizim kontrate", ku OE kërkon të pajiset me vërtetim për realizimin me sukses të kontratës Kalibrimi i Aparaturave të Laboratorit Qendror.	14.04.2025	OE u pajis nga ana e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me vërtetim për realizim me sukses , me shkresën nr. 2863/1 prot., datë 15.04.2025.	e plotë	0
8	14.04.2025	Kërkesë për vërtetim realizim kontrate", ku OE kërkon të pajiset me vërtetim për realizimin me sukses të kontratës Kalibrimi i Aparaturave të Laboratorit Qendror.	14.04.2025	Operatori Ekonomik, u pajis nga ana e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me vërtetim për realizim me sukses, me shkresën nr. 2864 prot., datë 14.04.2025	e plotë	0
9	14.04.2025	Kërkesë për vërtetim realizim kontrate", ku OE kërkon të pajiset me vërtetim për realizimin me sukses të kontratës Kalibrimi i Aparaturave të Laboratorit Qendror.	14.04.2025	OE u pajis nga ana e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me vërtetim për realizim me sukses , me shkresën nr. nr.2877 prot., datë 14.04.2025	e plotë	0
10	14.04.2025	Kërkesë për informacion mbi densitetin e naftës dhe benzines për periudhën 04.04.2025-10.04.2025	16.04.2025	Ne pergjigje te e-mail tuaj ju bejme me dije se nga analizimet e kryera ne Drejtorine e Laboratorit Qendror te ISHTI, per periudhen 04.04.2025-10.04.2025 te produkteve gazoil dhe benzine, kane rezultuar densitetet ne 15°C si me poshte: Gazoil nga 822.2 kg/m3 deri ne 841.4 kg/m3 Benzine nga 725.1 kg/m3 deri ne 743.5 kg/m3	e plotë	0

11	24.04.2025	Kërkohej informacion në lidhje me aktivitetin e subjektit që operon me prodhim, në ambalazhimin e bombolave të gazit, mbi inspektimet e kryera për periudhën 2020-2025, dhe nëse ka patur incidente në pesë vitet e fundit	30.4.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj lidhur me pztjete të cilat na drejtoni mund t'ju sqarojmë se: Gjatë periudhës 2020-2025 janë kryer inspektime nga ISHTI në zbatim të ligjit NR 10433, datë 16.06.2011" Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjeve sektoriale sipas drejtorive përkatëse inspektuese, në 5 vitet e fundit nuk kemi patur konstatime për incidente .	e plotë	0
12	29.04.2025	Kërkoj informacion mbi mundësinë që ofron INSTITUTI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL (ISHTI) për kryerjen e analizave për vajra lubrifikant	29.04.2025	Referuar kërkesës suaj, ju bejme me dije se: Vajrat lubrifikante analizohen duke përdorur standardin S SH ISO 8681:1986. Ne nuk bejme klasifikim të vajrave (motorri, hidraulik etj), por bejme vetëm analizimin e treguesve, të cilët janë të njëjtit, pavarësisht llojit të vajit. Treguesit e vajit nuk kanë një minimum dhe/apo maksimum. Gjithashtu ju bejme me dije që në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve kryhet edhe analizi i grashës dhe antifrizës. Ndërsa alkoolin e frenave dhe Ad Blue nuk i analizojmë si produkte.	e plotë	0